



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:226173

Datë: 19.02.2025

Numri i dokumentit: 06870489

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit M.K. me numër personal ..., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1200/2024, të datës 31.10.2024, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 19.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit në lëndën P.nr.260/2024 dhe me numër të marrëveshjes ND: 31/2025, e arritur me datën 19.02.2025 e pranuar nga gjyqtari me datë 19.02.2025, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
2. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2024:226173, 19.02.2025

Gj y q t a r i
Agron Maxhuni